



Prania / Dorezimi Priljeza/Priljeza Receipt/Delivery		16.02.2022	2	viti god year
Organ /Agestia Organ /Jednica Org /Unit	Br Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMSTK	815/2022		114	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.43/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.2628/2019 të datës 13.01.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.486/2019 të datës 21.08.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë Prishtinë, kundër Vendimit me numër protokoll Nr.1784 të datës 24.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në çështjen juridike "kontestim i masës disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 16.02.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën A.nr.486/2019 të datës 21.08.2019, të parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi nëpunës civil në Ministrinë për Ekonomi, me datë 21.08.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër protokoll 784 të datës 24.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, me pretendimin ankimor së vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 27.08.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ndërsa Këshilli

me datë 03.09.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokoll 4024/2019 së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes shkresës me numër protokoll 4750/2019 të datës 11.10.2019, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës A.nr.486/2019 të datës 21.08.2019, duke e udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të padisë në gjykatën kompetent në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 12.01.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2628/19, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 11.10.2019 dhe ka detyruar të njëjtin që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh të vendos për ankesën e ankueses A.nr.486/2019 të datës 21.08.2019.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e me numër protokoll 3727/2019 të datës 21.08.2019, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.1784 e datës 22.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën e datës 21.06.2019 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Ekonomisë; Shenjat e mjekut-raport i ndërprerjes së përkohshme për punë i datës 23.05.2019; Fletë lëshimi i Shërbimit Spitalor dhe KLINIK Universitar i Kosovës me numër amëze 1286 i datës 28.05.2019; Foto e mesazhit të dërguar në viber i datës 24.05.2019; Shkresa e aprovimit të pushimit nga Sistemi Informativ dhe Menaxhues i Burimeve Njerëzore- SIMBNJ i datës 19.06.2019; Shkresën e aprovimit të pushimit nga sistemi SIMBNJ i datës 02.07.2019; Shkresën-kërkesë së pushimit mjekësor nga sistemi SIMBNJ e datës 31.05.2019; Shkresën e kërkesës së pushimit vjetor nga Sistemi Informativ dhe Menaxhues i Burimeve Njerëzore SIMBNJ e datës 02.07.2019; Organogrami i Strukturës organizatave të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik; ndryshimi dhe Plotësimi Akt emërimit të ankuesit të datës 24.06.2016 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Katalogun e vendeve të punës në Shërbimin Civil të Kosovës i datës 21.02.2018; Vendimin e datës 25.05.2016; Tabelën e Klasifikimeve në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik të datës 18.07.2019; E-mailin e datës 18.07.2019; Emalin e datës 29.06.2019; Propozimet e institucioneve për klasifikimin e vendeve të punës të aprovuar nga Qeveria maj 2016; E-mailin e datës 22.05.2019; E-mialet e datës 30.05.2019; Vendimin me numër prot: 48 të datës 11.01.2019; E-maili e datës 03.06.2019; e-mailin e datës 22.05.2019 me e-mialet e bashkangjitura të datës 21.05.2019, Vërejtjen me shkrim me numër prot:1308 të datës 31.05.2019; Njoftimin e datës 29.07.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për ankuesin; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2017 për ankuesin i datës 27.12.2018; Shkresa e objektivave të punës të ankuesit për vitin 2018 të datës 27.12.2017; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018 i datës 26.12.2018 për ankuesin; E-mailin e datës 02.09.2019 me e-mailin e bashkangjitur të datës 02.09.2019; E-maili i datës 30.05.2019 me e-mailin e bashkangjitur të datës 22.05.2019; Përgjigjen e Sekretarit të Përgjithshëm në kërkesën e KZKA-së të datës 27.06.2019; E-mailin e datës 26.06.2019 me e-mialet e bashkangjitura të datës 30.05.2019, 22.05.2019; E-mailin e datës 24.06.2019; Raportin periodik i evidencës së hyrja daljeve në punë për periudhën 01.05.2019 deri më 31.05.2019; Njoftimin për pushim mjekësor përmes e-mailit të datës 30.05.2019; Njoftimin paralajmërues i datës 03.06.2016; Shqiptimin e masës disiplinore të datës 21.12.2018; E-mailin e datës 03.06.2019 me e-mialet e



bashkangjitura të datës 04.04.2019; E-mailin e datës 05.06.2019 me E-mailet e bashkangjitura të datës 03.05.2019; E-mailin e datës 06.06.2019 dërguar ministrit Njoftimin lidhur me ankesën e datës 21.06.2019; Procesverbalin e datës 26.06.2019; Vendimin e datës 11.01.2019; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimi të datës 12.06.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës për zyrtares Rregulloren Nr.40/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik; Rregulloren MF-Nr.01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; Shkresën e datës 02.09.2019 drejtuar zyrtares

Përmbajtjen e mesazhit të pranuar nga ana e ankuesit me datë 24.05.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.08.2019 si dhe përgjigjen në kërkesë të datës 02.09.2019; Njoftimin e datës 11.10.2019; Aktgjykimin A.nr.2628/2019 të datës 12.01.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentipër Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstatoi se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ sipas ankesës së ankuesit është bërë i pamundur, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, respektivisht sipas plotësim ndryshimit të Akt emërimit të datës 24.06.2016, është konstatuar se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik tani Ministria e Ekonomisë, në pozitën e punës Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme. Kundër të njëjtit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik me datë 31.05.2019 ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje me shkrim", ndërsa me datë 03.06.2019 ka percjell në emër të ankuesit shkresën paralajmëruese me numër protokoll 1320 "Njoftim paralajmërimi për shkelje të rënda-serioze", përmes së cilës ankuesi është paralajmëruar se shqiptimi i dy vërejtjeve me shkrim brenda një viti konsiderohet shkelje e rëndë-serioze.

Ankuesi i pakënaqur me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me shkrim", me datë 21.06.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Ky i fundit me Vendimin me numër protokoll 1784 të datës 24.07.2019 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi masën disiplinore "Vërejtje me shkrim" të datës 31.05.2019.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër protokoll 1784 e datës 24.07.2019 të KZKA-së, brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave. Me tej, shton se masa disiplinore "vërejtje me shkrim" e datës 31.05.2019 e shqiptuar nga Sekretari i Përgjithshëm ndaj ankuesit, ka qenë tendencioze, e pabazuar dhe në kundërshtim me të gjitha aktet ligjore dhe nën ligjore.

Kolegji me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike gjegjësisht të rrethanave të reja të krijuara pas parashtrimit të ankesës në Këshill, gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës respektivisht me datë 09.02.2022 ka kërkuar prova shtesë të organi i punësimit dhe rrjedhimisht ka konstatuar se me Vendimin me numër protokoll 251 të datës 10.02.2022 të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë, masa disiplinore "vërejtje me shkrim" e shqiptuar ndaj ankueses me datë 31.05.2019, është fshirë nga dosja e personel e tij dhe nga regjistri përkatës.



Andaj, bazuar në rrethanat si me lartë, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: "Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot", Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se qëllimi i ankesës A.nr.486/2019 i datës 21.08.2019, është bërë i pamundur -kotë, respektivisht objekti i kësaj ankese është i pamundur të shqyrtohet për faktin se masa disiplinore e kundërshtuar me ankesë është shuar me kalimin e afatit ligjor të përcaktuar me nenin 51 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe së e njëjta sipas Vendimit me numër protokolli 51 të datës 10.02.2022 të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë është fshirë nga dosja personale e ankuesit dhe nga regjistri përkatës, dhe rrjedhimisht Kolegji konstatoi që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr. 486/2019 të datës 21.08.2019.

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.43/2022

**Flakron GASHI**

  
Procesmbajtës



### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Personelit të Ministrisë së Ekonomisë;
- Znj. *Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative*;A
- Arkivit të KPMSHCK-së.

